



## NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 14 prill 2017, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Piro</b>	<b>MISHA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Zylyftar</b>	<b>BREGU</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Dhënien e autorizimit, shoqërisë “Triangle Media Group” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet, OTT “City Tv”. **(Vendimi nr. 43, datë 14.04.2017)**
2. “Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Eduart Feka, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Kuçova”. **(Vendimi nr. 44, datë 14.04.2017)**
3. “Miratimin e ndryshimeve në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës/autorizimit nga shoqëria “Tring TV” sh.a.” **(Vendimi nr. 45, datë 14.04.2017)**
4. “Kalimin e të drejtave që burojnë nga autorizimi, lëshuar për subjektin person fizik Xhezmie Rusta, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Rrasa”, tek shoqëria “Net 3 Digital” sh.p.k., ndryshimin e emërimit të subjektit nga “Tv Kabllor Rrasa” në “Net 3 Digital” si dhe azhurnimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Net 3 Digital” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Net 3 Digital” nga “Bashkia Belsh” në “Njësia Administrative Belsh”. **(Vendimi nr. 46, datë 14.04.2017)**
5. “Zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Prend Doda, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Besëlidhja” nga “Bashkitë Lezhë dhe Mirditë” në “Qytetet Lezhë dhe Rrëshen”. **(Vendimi nr. 47, datë 14.04.2017)**
6. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjorbë, nr. 26, datë 23.02.2017, vendosur ndaj subjektit person fizik Eduart Azizolli, autorizuar për subjektin “Tv Kabllor Iliria”. **(Vendimi nr. 48, datë 14.04.2017)**
7. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjorbë, nr. 29, datë 27.02.2017, vendosur ndaj subjektit person fizik Altin Sharka, autorizuar për subjektin “Tv Kabllor Hysgjokaj”. **(Vendimi nr. 49, datë 14.04.2017)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

8. “Ndryshimin e masës së sanksionit gjorbë, nr. 6, datë 19.01.2017, vendosur ndaj shoqërisë “Elbasan Cable” sh.p.k., autorizuar për subjektin “Tv Kabllor Elbasan Cable” nga 2,000,000 lekë në 120,000 lekë. **(Vendimi nr. 50, datë 14.04.2017)**
9. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjorbë, nr. 22, datë 14.02.2017, vendosur ndaj subjektit person fizik Erion Keta, autorizuar për subjektin “Tv Kabllor Ergi”. **(Vendimi nr. 51, datë 14.04.2017)**
10. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjorbë, nr. 28, datë 23.02.2017, vendosur ndaj subjektit person fizik Bajram Skraqi, autorizuar për subjektin “Tv Kabllor Fier-Shegan”. **(Vendimi nr. 52, datë 14.04.2017)**
11. Rrëzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjorbë, nr. 13, datë 27.01.2017, në masën 1,000,000 lekë, vendosur ndaj shoqërisë “Kombi” sh.p.k., autorizuar për subjektin audioviziv vendor “Tv Kombi”. **(Vendimi nr. 53, datë 14.04.2017)**
12. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjorbë, nr. 23, datë 15.02.2017, vendosur ndaj subjektit person fizik Rustem Xhelaj, autorizuar për subjektin “Tv Kabllor Cakran”. **(Vendimi nr. 54, datë 14.04.2017)**
13. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjorbë, nr. 20, datë 14.02.2017, vendosur ndaj subjektit person fizik Taulant Kurti, autorizuar për subjektin “Tv Kabllor Shalës”. **(Vendimi nr. 55, datë 14.04.2017)**
14. Rrëzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjorbë, nr. 27, datë 23.02.2017, në masën 1,000,000 lekë, vendosur ndaj subjektit person fizik Besnik Deliu, autorizuar për subjektin “Tv Kabllor K.A.M”. **(Vendimi nr. 56, datë 14.04.2017)**
15. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjorbë, nr. 31, datë 08.03.2017, vendosur ndaj subjektit person fizik Guri Meko, autorizuar për subjektin “Tv Kabllor ARAL”. **(Vendimi nr. 57, datë 14.04.2017)**

AMA ra dakord të marrë në shqyrtim në mbledhjen e ardhshme ankimet administrative ndaj:

- Vendimit me gjorbë të vendosur nga Grupi i Inspektimit/ose AMA ndaj shoqërisë “Arlibon” sh.p.k., autorizuar për subjektin “Tv Kabllor Fieri”. (Vendimi Nr. 17, datë 10.02.2017).
- Vendimit me gjorbë të vendosur nga Grupi i Inspektimit/ose AMA ndaj shoqërisë “Arlibon” sh.p.k., autorizuar për subjektin “Tv Kabllor Fieri”. (Vendimi Nr. 21, datë 15.02.2017).
- Vendimit me gjorbë të vendosur nga Grupi i Inspektimit/ose AMA ndaj shoqërisë “Arlibon” sh.p.k., autorizuar për subjektin “Tv Kabllor Fieri”. (Vendimi Nr. 25, datë 23.02.2017).

Tiranë, 19 prill 2017

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE